

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm ,Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti, në çështjen juridike të paditësit A.K. nga fshati Komuna Ferizajt, të cilin e përfaqëson me autorizim av.H.I., kundër të paditurve P.J., M.J.1 dhe L.J., ish nga Ferizaj tani me adresë të pa njohurë, të cilëve i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm av.M.P. nga Shtërpca, në çështjen juridike vërtetim pronësisë, pas seancën kryesore publike të mbajtur më 16.11.2016 në prezencën e përfaqësuesi të paditësit dhe përfaqësuesit të përkohshëm të paditurve, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I APROVOHET kërkesë padia e paditësit A.K. nga fshati Komuna Ferizajt, **si e bazuar.**

II VËRTETOHET se paditësi A.K. nga fshati Komuna Ferizajt, është pronar i paluajtshmërisë dhe atë NK.nr. 179-0 në sipërf. prej 10380 m² me kulturë “Mal” vendi i quajtur “Dreni” dhe NK.nr.264-2 me sipërf prej 20850 m² me kulturë “arë” në vendin e quajtur “Dreni” ZK

III DETYROHEN të paditurit P.J., D.J. dhe L.J., që t’ia pranojnë paditësit të drejtën e pronësisë, në paluajtshmërinë e blerë dhe t’ia bartin në emrin e tij në afat prej 15 ditësh, në të kundërtën, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, paditësit ky aktgjykimi do ti shërbej si dëshmi tabulare për bartjen e pronësisë në librat kadastral në Drejtorinë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Ferizajt, pa prezencën e të paditurve.

IV DETYROHET paditësi që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 100€ në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhune.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit në fjalën e tij ka deklaruar se mbesë në tërësi pran padisë dhe kërkesë, precizimit subjektiv të bërë në seancën e dt.16.08.2016, duke shtuar se nga provat e

administruara, dëgjimin e dëshmitareve, kontrata me shkrim e datës 12.01.1984 është vërtetuar fakti se paditësi i ka blerë këto paluajtshmëri nga trashëgimtarët e S.J. , sipas kontratës të lart cekur.

Se këto ngastra i ka blerë paditësit kjo është vërtetuar edhe me anë të deklaratës së dhënë nga M.J.1 të vërtetuar në Gjykatën Themelore në Kragujevc Republika e Serbisë e cila është administruar si provë, andaj, nga provat e administruara u vërtetua se paditësi i ka blerë këto paluajtshmëri me të cilin e ka fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje prej më shumë se 20 vitesh, si posedues me mirëbesim, dhe të njëjtat gjatë tërë kësaj periudhe i ka shfrytëzuar pa kurrfarë pengese prej askujt dhe as nga të paditurit.

I ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Nuk është deklaruar për shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve në fjalën e tij ka deklaruar se mbesë pranë përgjigjes në padi, në fillim e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa pas dëgjimit të dëshmitarëve A.A. dhe R.K., ka theksuar se është vërtetua fakti se paditësi i ka blerë këto paluajtshmëri nga trashëgimtarët e të paditurve e cila është vërtetuar me provat e administruara dhe atë veçanërisht me deklaratën e M.J. e cila është vërtetuar në Gjykatën Themelore në Kragujevc Republika e Serbisë me nr. VR.12555/2010 dt.01.10.2010, me të cilën deklaratë pa kurrfarë dyshimi u vërtetua se paditësi pasurinë e cila është shënuar në fletën poseduese, e ka blerë nga trashëgimtarët e të paditurve, ku ka deklaruar se nga këto prova rezulton se kërkesë padia e paditësit është e bazuar.

Nuk i kërkuar shpenzimet e procedurës, pasi që ka deklaruar se paraprakisht paditësi i ka përmbushur në tërësi.

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave sipas propozimit të palëve bëri administrimin e këtyre provave: Lexohet padia e paditësit C.nr.140/08, dt.09.04.2008, e cila tani evidentohet me nr. C.nr.353/16, autorizimi i paditësit dhënë av. H.I., kontrata e dt.12.01.1984 e nënshkruar nga shitësit M.J.2 dhe M.M. (në pjesën hyrëse të kësaj kontrate shihet mbiemri J. në gjuhën serbe), kontrata e dt.12.01.1984 e

përpiluar me dorëshkrim, e nënshkruar nga paditësi , shitësi , si dhe nga dëshmitari A.A. dhe D.Xh., (në gjuhën serbe), Dëftesa e dt.12.02.1984 (në gjuhën serbe) , certifikata e vdekjes për M.J.2 , lëshuar nga R.Serbisë dt.08.11.2012, certifikata e vdekjes për M.J.1 lëshuar nga autoritet e R.Serbisë dt.09.08.2015, deklarata e dt.01.10.2010 e nënshkruar nga M.J.1 e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Kragujevc R.Serbisë, parashtresa e të autorizuarit të paditësit dt.28.04.2016, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 140/08 dt.14.04.2016, fleta poseduese me nr.16 e dt.02.08.2007, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 353/16 dt.29.06.2016, me të cilën të paditurve i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm av.M.P. nga Shtërpca (në tri gjuhë, shqip , serbisht dhe anglisht), procesverbali i dt.16.08.2016, me të cilën është bërë precizimi subjektiv i padisë, nga ana e të autorizuarit të paditësit, përgjigja në padi, e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurve, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë E.P. dt.16.10.2016, certifikata pronësore me nr. 22-33693 dt.13.10.2016, lëshuar në emër të S.J., Skica e matjes e nënshkruar nga eksperti E.P..

Bazuar në provat e administruara, vlerësimin e tyre një nga një dhe në lidhmëri me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga provat e administruara kontrata për shitblerjen e paluajtshmërive me shkrim e dt.12.01.1984, deklarata e përpiluar me shkrim, dhe e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Kragujevc, dëgjimi i dëshmitareve është vërtetuar fakti se paditësi me trashëgimtarët e të paditurve kanë lidhur kontrate për shitblerjen e këtyre paluajtshmerive dhe se kontrata është përmbushur në tërësi dhe se paditësi të drejtën e pronësisë në këto ngastra e ka fituar në bazë të kontratës me shkrim mbi shitblerjen e palujtshmërisë para 32 viteve, dhe se nga koha e shitblerjes së paluajtshmërive e deri më tani paditësi i mban në posedim të qetë dhe të pa penguar nga askush e as nga të paditurit.

Gjykata ka gjetur se provat e administruara përputhen në tërësi njëra me tjetrën si dhe me gjendjen faktike të cilën gjykata e ka konstatuar me daljen në vend, me anë të ekspertit të gjeodezisë në parcelën kontestuese, ku ka vërtetuar se parcela kontestuese me nr. 179-0 në sipërf. prej 10380m² me kulturë “Mal” vendi i quajtur “Dreni” dhe NK.nr.264-2 me sipërfaqe prej 20850 m² në vendin e quajtur “Dreni” me kulturë arë e klasit të 5-të, këto ngastra kontestuese që janë objekt i këtij kontesti të cilat janë përshkruar hollësisht nga ana e ekspertit të

gjeodezisë me përkufizime përkatëse, të cila kanë qenë objekt i shitblerjes me anë të kontratës së dt.12.01.1984

Gjykata sipas certifikatës së vdekjes për M.J.2 dhe M.J.1, është konstatuar se të njëjtit kanë vdekur kurse si trashëgimtar të tij i autorizuari i paditësit me anë të parashtresës së dt.28.04.2016, e ka zgjeruar ndaj të paditurve, kurse me deklaratën e dhënë të M.J.1 e dt.01.10.2010 zë vërtetuar në Gjykatën Themelore në Kragujevc R.Serbisë me nr.VR.nr.12550/210, është vërtetua fakti trashëgimlënsit e të paditurve i kanë pranuar të hollat në emër të shitblerjes së këtyre paluajtshmërive dhe nuk ia kanë kontestuar pronësinë paditësit, por meqenëse të njëjtit kanë vdekur, kurse trashëgimtarët e tij kanë qenë me adresë të panjohur gjykata ua ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm me qëllim të mbrojtjen e interesave të paditurve në këtë çështje kontestimore.

Gjykata bëri edhe nxjerrën e provave përmes dëgjimit të dëshmitarit A.A. i cili ka deklaruar se në kohën e shitblerjes së këtyre paluajtshmërive në mes shitësve M.J.2 dhe M.M.3, dhe blerësit tani paditësit A.K. kam qenë prezent me rastin e shitblerjes së kësaj paluajtshmërie, marrëveshja rreth shitblerjes së kësaj paluajtshmërie është bërë në shtëpinë e dëshmitarit tani të vdekur D.Xh. , ku dhe jemi pajtuar në lidhje me shitblerjen dhe çmimin kontraktues.

Njëherit ka shtuar se rreth një muaj pas marrëveshjes së bashku me paditësin kemi shkuar në Kragujevc në R.Serbisë, ku ia kemi dorëzuar të hollat e çmimit kontraktues, ku mësa më kujtohet gjysma e tyre kanë qenë e valutës dinar, ndërsa gjysma tjetër kanë qenë marka, dhe nga ajo kohë paditësi këto toka i ka shfrytëzuar pa ndërprerë dhe i ka punuar, ku dhe tani i shfrytëzon, dhe asnjëherë nuk ka pasur pengesë në shfrytëzimin e tyre.

Dëshmitari R.K., ka deklaruar se këto paluajtshmëri paditësi i ka blerë rreth vitit 1984, nga një qytetar i nacionalitetit serb, emri saktë nuk më kujtohet por mbiemrin e ka pasur J., ku nga ajo kohë paditësi i ka shfrytëzuar dhe punuar dhe njëherit nuk është penguar nga askush, të cilat i punon edhe sot.

Vlenë të theksohet se prezent në shitblerjen e asaj kohe ka qenë edhe D.Xh., ku me të njëjtin gjatë asaj kohe kemi pasur biseda pasi që fshati nga unë vij, dhe fshati ku gjendet këto paluajtshmëri, respektivisht vendbanimi i D.Xh. janë afër dhe i njëjti më ka konfirmuar në atë

kohë, se ka ekzistuar një marrëveshje në mes paditësit dhe familjes J., ku më kanë thënë se ka qenë prezent me rastin e lidhjes së kësaj marrëveshje, ku me sa jam në dijeni tani i njëjti ka ndërruar jetë .

Gjykata këtyre dëshmime ua fali besimin sa i përket faktit se paditësi ka hyrë në posedim në paluajtshmëritë kontestuese pasi që të njëjtit janë fqinjë me paditësin dhe të njëjtit jetojnë në të njëjtin fshat, kurse sa i përket dëshmisë së dëshmitarit A.A. i cili ka deklaruar se ka qenë prezent me rastin e lidhjes së marrëveshjes për shitblerjen e këtyre paluajtshmërive gjykata e vërtetoi edhe me faktin se i njëjti në cilësi të dëshmitarit e ka nënshkruar kontratën e dt.12.01.1984, e lidhur në mes paditësit dhe shitësve.

Gjykata me rastin e daljes në vend shikim në paluajtshmëritë kontestuese me ekspertin e gjeodezisë E.P. ka vërtetuar se ngastra kontestuese 179-0 në sipërf prej 10380 m² me kulturë “Mal” vendi i quajtur “Dreni” kufizohet nga veri me NK.nr. 2265 P.SH. rrugë publike prej pikës 1-2,3 në gjatësi prej 254.95m, nga lindja me NK.nr.592-0 PSH. rrugë publike prej pikës 3-4 në gjerësi prej 89.12m, nga jugu me NK.nr.178-0 e cila evidentohet në emër të M.A. prej pikës 4-5 në gjatësi prej 225.66m, nga perëndimi me NK.nr.176-0 e cila evidentohet në emër të I.O. prej pikës 4-1 në gjerësi prej 14.45m,

Kurse NK.nr.264-2 në sipërf prej 20850m² me kultur ar; vendi i quajtur Dreni kufizohet nga veri me NK.nr. 264-1, e cila evidentohet në emër të N.D. dhe I.V. me nga ½ prej pikës 1-2 në gjatësi prej 273.12m nga jugu dhe lindja kufizohet me P.SH. rruga Ferizaj-....., prej pikës 2-3 në gjatësi prej 310.73m, nga perëndimi me NK.nr.591-0 P.SH. Rr. prej pikës 3-1, në gjerësi prej 152.48.

Gjykata pas vlerësimit të provave lidhur me faktet ka vërtetuar se paditësi nga viti 1984 ka hyrë në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim në paluajtshmëritë kontestuese sipas kontratës mbi shitblerjen e përpiluar me shkrim dhe nga ajo kohë i njëjti e ka në posedim të vazhdueshëm dhe të papenguar nga askush, pra as nga trashëgimlënësit e të paditurve e as nga të paditurit.

Paditësi A.K. sipas bazës juridike mbajtjes me mirëbesim në kuptim të nenit 28 par.1,2 lidhur me par.4 të LTHMPJ nr.6/1980 e ka fituar të drejtën e pronësisë në ngastrën

kadastrale179-0 në sipërf. prej 10380m² me kultur mal vendi i quajtur Dreni dhe NK.nr.Nr.264-2 në sipërf prej 20850m² në vendin e quajtur “Dreni” me kulturë arë, ZK.....

Gjykata ka vlerësuar edhe thëniet e përfaqësuesit të përkohshme të paditurve i cili përmes përgjigjes në padi fillimisht e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesë padinë e paditësit, si të pa bazuar, por pas administrimit të provave dhe atë kontratës mbi shitblerjen e përpiluar me shkrim dhe deklaratës së dhënë të M.J.1 e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Kragujevc R.Serbisë me nr. VR.12555/2010 dt.01.10.2010, si dhe nga dëgjimi i dëshmitarëve A.A. dhe R.K., ka theksuar se është vërtetuar se paditësi ka hyrë në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim në paluajtshmërin kontestuese para më shumë se 32 vite pra në vitin 1984 sipas kontratës së shitblerjes, e të cilat thënie të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurve gjykata i vlerësoj si reale e në përputhje me provat e administruara.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së ku obligohet paditësi që të paguan shumën prej 100€ dhe për takse gjyqësore për padi shumën prej 50€ dhe aktgjykim prej 50€, kurse shpenzimet tjera meqenëse paditësi i ka përmbushur nuk ka vendosur lidhur me to.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.353/16 më dt.16.11.2016

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj gjykate.